



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME E NDËRTIMIT "KARL GEGA" TIRANË**

Nr. 265 Prot.

Tiranë, më 08.09 / 2025

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele për mësues të kulturës profesionale

Drejtuar :

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 16.02.2017 , "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 554 date 31.07.2019 " Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensisë Kombëtare të Punesimit dhe Aftësive (AKPA) , Udhëzimt të MFE, Nr.25, datë 01.09.2023 nr 15702 prot "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet arsimi profesional" Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Nr.759, datë 30.09.2024 "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJEN E NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT" , neni 118 , Udhëzimi i Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 4, datë 18.8.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024 ofruesi publik i AFP-së. Shkolla e mesme e ndërtimit "Karl Gega", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- **Mësues të formimit të kulturës profesionale , inxhinier mësues TIK – 1 (Një) (Mësues për Lëndën TIK)**

1. **Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:**

- **Kritere të përgjithshme :**

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

- **Kritere të posaçme për mësues të teorisë dhe/ose të praktikës profesionale:**

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të AFP-së, brenda datës ...17.09.2025

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Konceptoi: B. Shehaj
Pranoi: F. Selimja
Miratoi: I. Gorçe
Konfirmoi: I. Gorçe

